

Vendimarrja e AP

Neni 16

Verifikimi i ligjshmërisë së akteve

1. Zbatimi i akteve të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për vetëqeverisjen vendore.

2. Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme

: a) çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijani nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit;

b) për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

ii) vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës "a", të kësaj pike;

iii) në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është 6 organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarinimin e pavlefshëm të këtij akti. Prefekti i qarkut ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti;

iv) në rastet kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën "b", nënparagrafi "i", të kësaj pike, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kur kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, prefekti i qarkut njofton organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 20

Vendimarrja

1. Në zbatim të përgjegjësive të tij sipas këtij ligji, prefekti i qarkut nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim.

2. Aktet e prefektit të qarkut bëhen të zbatueshme pas marrjes dijani të subjekteve të cilave u drejtohen.

3. Në rastet kur lindin konflikte ndërmjet një ministrie ose drejtuesit të një institucioni qendror dhe prefektit të qarkut për urdhrat ose udhëzimet që ai ka nxjerrë, zgjidhja bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij ligji.

4. Për rastet e konflikteve të subjekteve, të papërmendura në pikën 3, të këtij neni, dhe prefektit të qarkut, palës së interesuar i lind e drejta t'i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative.

Vendimarrja lidhur me patentat e huaja.

Në mbështetje të Ligjit 8378 dt.22.07.1998, i ndryshuar me Ligjin nr.10448, datë 05.12.2011, "*Për Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë*", neni 7 pika 12, dhe Udhëzimit të M.P.B. nr. 687, datë 5.12.2013, "*Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor*", Komisioni i ngritur me Urdhër të Prefektit të Qarkut Vlorë shqyrton shkresën e drejtuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë dhe procesverbalin përkatës lidhur me pezullimin apo jo të lejedrejtimit në varësi të shkeljes dhe rrethanave të ngjarjes.

Si përfundim Prefekti i Qarkut Vlorë del me Vendim. Vendimi hartohet në tri kopje orgjinale me vlerë të njëjtë përdorimi, nga të cilat, një kopje kundravajtësi, një kopje Policisë Rrugore, bashkëngjitur leja e drejtimit origjinale dhe një kopje komisioni.